

Braktisësit e hershëm të shkollës në rradhët e të rriturve dhe arsimit i mundësisë së dytë

## **Bashkohuni me komunitetin e EPALE të përbërë nga më shumë se 28 000 specialistë të të nxënimit për të rritur për të vlerësuar, komentuar dhe kontribuar!**

Të dashur kolegë të EPALE,

Fokusi tematik i EPALE për muajin korrik ishte tek **braktisësit e hershëm të shkollës në rradhët e të rriturve dhe arsimit i mundësisë së dytë**. Ne promovuam rolin e shkollave të mundësisë së dytë për ofrimin e një mundësie tjetër për nxënësit e rritur për të marrë një kualifikim, për të përmirësuar cilësinë e jetës së tyre dhe për t'u integruar në shoqëri. Gjatë kësaj kohe ekipet kombëtare dhe komuniteti i EPALE kanë publikuar një sërë rastesh frymëzuese studimore, artikujsh, raportesh dhe burimesh të tjera. Ju mund t'i gjeni ato në faqen tonë të posaçme **Shkollat e Mundësisë së Dytë**.

[Shihni një përmbledhje të fokusit të EPALE në muajin korrik, të përgatitur nga Koordinatori Tematik Andrew McCoshan.] (në gjuhën angleze)

### **Postime në formë blogu**

**Ngushtimi i hendekut të kredibilitetit: Nevoja për përdorimin e strategjisë "assertive outreach" për të angazhuar braktisësit e hershëm të shkollës në rradhët e të rriturve** (në gjuhën angleze, spanjolle, frënge, italiane, polake).

Paul Downes, Drejtor i Qendrës për Disavantazhin Arsimor në City University në Dublin identifikoi se ku qëndrojnë mangësitë përse i përket ofertës për të rriturit që braktisin shkollën herët dhe e përcaktoi rastin si rast që duhet zgjidhur nëpërmjet "*assertive outreach*". (*Assertive outreach*- është një metodë efektive për ofrimin e shërbimeve tek grupet e të rinjve më të vështirë për t'u kontaktuar dhe që kanë nevojë për mbështetje).

**Rreziqet shoqërore të shoqëruara me skemat e të nxënimit nëpërmjet punës** (në gjuhën angleze dhe frënge)

Koordinatori Tematik **Simon Broek** foli në lidhje me risqet e skemave të të nxënimit nëpërmjet punës për të rriturit që braktisin shkollën herët dhe për grupet e tjera vulnerabël.

**Lufta kundër analfabetizmit funksional me Shkollat e Mundësisë së Dytë - një shembull nga Serbia** (në gjuhën angleze)

Asistent lektori dhe nxënësi i Doktoraturës në Universitetin e Beogradit, **Aleksandar Bulajić**, ndanë me ne një histori frymëzuese për mënyrën sesi Serbia po përballet me analfabetizmin funksional tek të rriturit nëpërmjet arsimit të mundësisë së dytë.

## **[Shkrim-këndimi funksional dhe braktisja e hershme e shkollës]** (në gjuhën angleze)

Një nga pasojat e braktisjes së hershme të shkollës është që të rinjtë largohen nga shkolla pa arritur nivelin funksional të shkrim-këndimit. Në këtë blog Koordinatori Tematik **David Mallows** shqyrtoi se çfarë do të thotë kjo për shoqërinë tonë dhe pse është diçka e rëndësishme.

### **Lajme nga mbarë Europa**

Shumë gjëra kanë ndodhur gjatë muajit korrik në sektorin e të nxënimit për të rriturit në mbarë Europën:

- Ministria Daneze e Arsimit ka deklaruar që ajo do të **ofrojë mbështetje financiare** për projektet që prodhojnë materiale, mjete dhe kurse për mësimdhënien dixhitale (në gjuhën daneze).
- Ministria e Arsimit dhe Punësimit ka deklaruar që ajo do të **lançojë një program të të nxënimit për rritur** për kurse të aftësive bazë dhe gjuhëve të huaja (në gjuhën angleze dhe malazeze).
- Ndërkohë në Lituani Ministria e Arsimit së bashku me Qendrën për Zhvillimin e Kualifikimeve dhe të AFP vizituan 10 bashki për të **prezantuar platforma të ndryshme elektronike** që kanë të bëjnë me të nxënimit për të rriturit (në gjuhën lituaneze).

### **Bashkohuni tani!**

Mos harroni të regjistroheni në EPALE që të keni mundësi për të bashkëndarë opinionet tuaja mbi këto postime. **Bashkohuni tani** dhe bëhuni pjesë e komunitetit të përbërë nga 28 000 profesionistë të të Nxënimit për të Rritur .